**VENDIM**
**Nr.59, datë 8.9.2010**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HYDROENERGY" SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", neneve 9 dhe 13 pika 1, germa "d" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1, germa "g", neneve 13 dhe 14 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.9.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "HydroEnergy" sh.p.k. për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson tërësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë "HydroEnergy" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
**Bujar Nepravishta**